



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.155

20 nëntor

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.954, datë 30.9.2009	Për organizimin, strukturën, funksionimin e Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD) dhe bashkëveprimin me institucionet shtetërore, që kanë interesa në det	6951
Vendim i KM nr.997, datë 13.5.2009	Për një shtesë në vendimin nr.260, datë 18.4.2007 të Këshillit të Ministrave “Për botimin, shtypjen dhe shpërndarjen e teksteve shkollore, të sistemit të arsimit parauniversitar”, të ndryshuar	6955
Vendim i KM nr.998, datë 30.9.2009	Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, bursat e shtetit dhe pagesat e nxënësve dhe të studentëve, në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2009-2010..	6955
Vendim i KM nr.999, datë 30.9.2009	Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të dytë, “Master i nivelit të parë”, në Universitetin “Ismaël Qemali”, Vlorë...	6961
Vendim i KM nr.1000, datë 30.9.2009	Për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë, “Master i nivelit të parë”, në Universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër	6962
Vendim i KM nr.1001, datë 30.9.2009	Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të dytë, “Master i nivelit të parë”, në Universitetin e Tiranës	6963
Vendim i KM nr.1002, datë 30.9.2009	Për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë, në universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës	6963
Vendim i KM nr.1003, datë 30.9.2009	Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të dytë në Universitetin “Eqerem Çabej”, Gjirokastër	6964
Vendim i KM nr.1004, datë 8.10.2009	Për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë, “Master i nivelit të dytë”, në gjuhën shqipe, në Qendrën Ndëruniversitare të Studimeve Albanologjike	6965

Vendim i KM nr.1005, datë 8.10.2009	Për hapjen e programeve të studimeve të ciklit të tretë “Master i nivelit të dytë”, në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të Universitetit Politeknik të Tiranës 6965
Vendim i KM nr.1006, datë 8.10.2009	Për hapjen e programeve të studimeve të ciklit të tretë, “Master i nivelit të dytë”, në Fakultetin e Historisë e Filologjisë, të Gjuhëve të Huaja dhe të Shkencave Natyrore, të Universitetit të Tiranës 6966
Vendim i KM nr.1007, datë 8.10.2009	Për një ndryshim në vendimin nr.863, datë 29.7.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strategjisë së shkencës, të teknologjisë dhe inovacionit, 2009-2015” 6968
Vendim i KM nr.1011, datë 14.10.2009	Për miratimin e marrëveshjes së grantit PHRD, no.tf 093096, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për përgatitjen e projektit të qeverisjes, financave dhe dhënies së shërbimeve bashkiake 6968
Vendim i KM nr.1013, datë 14.10.2009	Për disa ndryshime në vendimin nr.399, datë 22.4.2009 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin, funksionimin dhe përbërjen e Komisionit Qendror të Regjistrimit” 6978
Vendim i KM nr.1015, datë 14.10.2009	Për lejimin e shtyrjes së afatit të procedurave të prokurimit, me objekt, përkatësisht, “Licencimi i plotë i sistemit të Thesarit” dhe “Shërbim konsulence për sistemin kompjuterik të Thesarit”, në Ministrinë e Financave 6978
Vendim i KM nr.1016, datë 14.10.2009	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2009, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës..... 6979

VENDIM
Nr.954, datë 30.9.2009

**PËR ORGANIZIMIN, STRUKTURËN, FUNKSIONIMIN E QENDRËS
NDËRINSTITUCIONALE OPERACIONALE DETARE (QNOD) DHE BASHKËVEPRIMIN
ME INSTITUCIONET SHTETËRORE, QË KANË INTERESA NË DET**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 32 të ligjit nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të neneve 3, pika 3, e 4/1, pika 3, të ligjit nr.8875, datë 4.4.2002 “Për Rojën Bregdetare Shqiptare”, të ndryshuar, dhe të neneve 6, 29 e 41 të ligjit nr.9861, datë 24.1.2008 “Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Përkufizime

Në kuptim të këtij vendimi, me termat e mëposhtëm nënkuptohen:

a) “Mjet detar”, një anije patrulluese, anije ndihmuese, mjet i shpejtë lundrues etj., që drejtohet nga një ekuipazh i stërvitur dhe i pajisur me pajisjet e përshtatshme për kryerjen e operacioneve detare.

b) “Komandant në terren”, personi që kontrollon drejtpërdrejt mjetet detare, të përfshira në një operacion të veçantë dhe që drejton, nga pikëpamja taktike, operacionin në terren, në drejtimin e oficerit të shërbimit të QNOD-së.

c) “Pavarësia operationale e QNOD-së”, autoriteti i kësaj qendre për të marrë vendime dhe për të komanduar gjatë operacioneve detare.

ç) “Varësi administrative”, eprori që ka përgjegjësinë për t’i siguruar QNOD-së mbështetjen logjistike, mirëmbajtjen e pajisjeve administrative, sigurimin e mjediseve, si dhe personelin e nevojshëm për përmbushjen e detyrave të sipërpërmendura.

d) “Kontrolli operacional”, autoriteti i ngarkuar për të drejtuar të tjerët në përmbushjen e detyrave të caktuara.

dh) “Transferimi i autoritetit”, rasti kur e drejta për të drejtuar të tjerët transferohet nga një institucion ose person te një tjetër, si p.sh. transferimi i kontrollit operacional të një situatë të dhënë nga autoritetet ushtarake tek autoritetet civile gjatë operacioneve të zbatimit të ligjit.

II. Misioni dhe detyrat e QNOD-së

1. Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD) është një strukturë ndërinstitucionale bashkërenduese, që ka detyrë organizimin, planizimin dhe drejtimin e operacioneve detare, në të gjithë hapësirën detare, në përputhje me legjislacionin detar vendas e ndërkombëtar. QNOD-ja do të funksionojë në përputhje me kuadrin ligjor shqiptar, i cili ngarkon me përgjegjësi kryesore Ministrinë e Brendshme për menaxhimin dhe kontrollin e kufijve shqiptarë, së bashku me ministrinë e tjera, të cilat kanë autoritet të ndryshëm në det. QNOD-ja është një platformë bashkëpunimi, ku personeli është në varësi të institucionit përkatës, i caktuar për të garantuar bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës për menaxhimin e hapësirës detare shqiptare. QNOD-ja bashkërendon operacionet e kërkim-shpëtimit dhe të dhënies së ndihmës në det, si dhe parandalon e mbron mjedisin detar nga ndotja. QNOD-ja e garanton këtë nëpërmjet bashkërendimit dhe bashkëpunimit efikas me të gjitha institucionet pjesëmarrëse dhe nëpërmjet bashkërendimit të të gjitha burimeve të disponueshme, si mjetet detare, ajrore e tokësore, sistemet, personelin etj. QNOD-ja bashkërendon planin e mbështetjes me mjete detare dhe burime të tjera, në dispozicion të të gjitha institucioneve pjesëmarrëse, dhe përgatit rekomandimet e nevojshme për trajnimin profesional, kualifikimet dhe arritjen e standardeve të kërkuara nga të gjitha institucionet e përfshira në operacionet detare.

2. QNOD-ja funksionon edhe si:

a) qendër komandimi për operacionet detare;

b) qendër raportimi dhe informacioni;

- c) qendër kombëtare për kërkimin dhe shpëtimin në det;
- ç) qendër për shkëmbim informacioni me strukturat partnere.
- 3. QNOD-ja, si qendër komandimi operacional detar, nënkupton:
 - a) drejtimin e të gjitha mjeteve detare, të përfshira në operacionet e kësaj qendre;
 - b) bashkërendimin e punës për planifikimin e përdorimit të integruar vjetor të mjeteve dhe të infrastrukturës përkatëse.
- 4. QNOD-ja, si qendër raportimi dhe informacioni, nënkupton:
 - a) grumbullimin e informacionit për situatat detare, përsa i përket hapësirës detare shqiptare;
 - b) Qendra, në përmbushje të misionit të përcaktuar në pikën 1 të kreut II të këtij vendimi, garanton transmetimin efikas të informacionit në Ministrinë e Brendshme. QNOD-ja përpunon dhe transmeton informacionin drejtpërdrejt tek institucionet e tjera përgjegjëse, në varësi të llojit të operacionit, që po kryhet. Transmetimi i informacionit kryhet nga oficerët koordinatorë, të caktuar nga institucionet përkatëse;
 - c) hartimin e raporteve periodike për institucionet e përfshira;
 - ç) përgatitjen e raporteve të përbashkët a të riskut për situatën detare.
- 5. QNOD-ja, si qendër kombëtare për kërkim-shpëtimin në det (MRCC), nënkupton:
 - a) organizimin dhe zbatimin e detyrave, në përputhje me planin kombëtar të kërkim-shpëtimit në det dhe me manualin e kërkim-shpëtimit në det;
 - b) bashkërendimin e punës me qendrat e kërkim-shpëtimit të vendeve fqinje.
- 6. QNOD-ja mund të komandojë edhe mjete detare private, në rastet e operacioneve të kërkim-shpëtimit në det, kur këto mjete vendosen në dispozicion të operacioneve, sipas dispozitave ligjore.
- 7. Në fillim të çdo viti, për planifikimin dhe përmbushjen e misionit, institucionet pjesëmarrëse në QNOD bëjnë deklarinë vjetor të mjeteve detare, që kanë në inventar, si dhe përditësimin e gatishmërisë teknike dhe të veprimtarisë operacionale të tyre.

III. Organizimi i QNOD-së

- 1. Struktura e QNOD-së është sipas shtojcës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
- 2. QNOD-ja ka në përbërje strukturore personel nga të gjitha institucionet, që kanë kompetenca dhe kryejnë detyra në bregdet e në hapësirën detare, sipas nenit 32 të ligjit nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, siç janë:
 - Ministria e Financave (prani 24-orëshe të doganave);
 - Ministria e Brendshme (prani 24-orëshe të Policisë së Kufirit dhe Migracionit);
 - Ministria e Mbrojtjes (prani 24-orëshe të Rojës Bregdetare);
 - Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (prani 24-orëshe të Inspektoratit të Peshkimit);
 - Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (kapacitet bashkërendues, sipas nevojës);
 - Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (kapacitet bashkërendues, sipas nevojës);
 - Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (kapacitet bashkërendues sipas nevojës).
- 3. Mjediset e QNOD-së janë në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes.
- 4. Pagesa e personelit të QNOD-së bëhet nga institucionet përkatëse, që emërojnë këtë personel.
- 5. Personat e caktuar në QNOD janë përfaqësues të institucioneve të përfshira sipas nenit 32 të ligjit nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, dhe do të jenë në varësi të institucioneve, që ata përfaqësojnë.
- 6. Përbërja e strukturës së QNOD-së është si më poshtë vijon:
 - a) Drejtori administrativ;
 - b) Kontrollorët e lartë të institucioneve;
 - c) Koordinatorët e institucioneve;
 - ç) Oficerët e shërbimit;
 - d) Kontrollorët civilë të turnit;

dh) Personeli i shërbimit;

e) Personeli i mbështetjes administrative dhe teknike.

7. Detyrat që kryejnë strukturat e QNOD-së janë si më poshtë vijon:

- Drejtori administrativ, i cili caktohet nga Ministri i Mbrojtjes, është përgjegjës për përgatitjen e rekomandimeve të buxhetit vjetor, që i paraqiten Ministrisë së Mbrojtjes, për shpenzimet për personelin operacional, për mirëmbajtjen e pajisjeve, për të garantuar zbatimin e procedurave operacionale standarde, të miratuara, si dhe transmetimin e raporteve, të miratuara dhe të nevojshme. Ai ka detyrë të informojë rregullisht Ministrinë e Mbrojtjes dhe ministrinë e tjera pjesëmarrëse për problemet ose çështjet, që ndikojnë në mirëfunksionimin e QNOD-së.

- Koordinatorët e institucioneve janë përfaqësues të caktuar nga institucionet e përmendura në pikën 2 të nenit 32 të ligjit nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë” dhe i përfaqësojnë ato gjatë planifikimit, të përditshëm dhe afatgjatë, operacional. Koordinatorët janë përgjegjës për zhvillimin e bashkërenduar dhe zbatimin e planeve operacionale të QNOD-së, të miratuara bashkërisht, për vlerësimet e riskut, rekomandimet e trajnimeve dhe të planeve, në përputhje me vendimet përkatëse.

- Oficerët e shërbimit janë oficerët përgjegjës për personelin, që shërben në sallën operacionale të QNOD-së. Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave do të kenë oficerë shërbimi 24 orë, në sallën operacionale të QNOD-së. Secili oficer shërbimi është përgjegjës për drejtimin e operacioneve, që janë kompetencë e ministrisë, që përfaqëson. Për sigurimin e kontrollit civil mbi të gjitha operacionet policore, oficeri i shërbimit, i caktuar nga Ministria e Brendshme, do të marrë përsipër dhe do të ekzekutojë operacionet, që lidhen me detyrat e policisë. Personeli i shërbimit të QNOD-së do të shërbejë në turne të caktuara, për të garantuar funksionimin në mënyrë të pandërprerë. Përgjegjësitë dhe bashkërendimi i punës së oficerëve të shërbimit përshkruhen në procedurat operacionale, të miratuara.

- Personeli i operacioneve dhe i shërbimit të QNOD-së caktohen nga Ministria e Mbrojtjes dhe do të jenë operatorë të trajnuar radarësh dhe/ose personel i ndërlidhjes.

- Personeli administrativ dhe ai teknik është personel i caktuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe siguron mbarëvajtjen e sistemeve e mirëfunksionimin e pajisjeve të QNOD-së.

8. QNOD-ja vendoset në mjedise të siguruara nga Ministria e Mbrojtjes. Të gjitha pajisjet e nevojshme për QNOD-në sigurohen po nga Ministria e Mbrojtjes.

9. QNOD-ja mbledh informacion nga sistemi i vëzhgimit së hapësirës detare dhe nga sensorë të tjerë, pajisje ose mjete detare, të përfshira në operacione për kontrollin e hapësirës detare.

IV. Operacionet e QNOD-së

1. Operacionet e QNOD-së përcaktohen në manualin e procedurave standarde operacionale, të miratuar nga Ministri i Brendshëm dhe Ministri i Mbrojtjes, pas bashkërendimit me institucionet e tjera pjesëmarrëse. Në të njëjtën mënyrë miratohet edhe plani vjetor operacional i QNOD-së.

2. QNOD-ja drejton dhe bashkërendon operacionet detare të institucioneve të mëposhtme:

a) Ministrisë së Brendshme:

i) Operacionet detare për kontrollin e kufirit dhe të luftës kundër trafikut të paligjshëm.

ii) Operacionet detare të luftës kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar.

iii) Operacionet detare për detyra të tjera policore.

b) Ministrisë së Mbrojtjes:

i) Operacionet e kërkim-shpëtimit dhe dhënies së ndihmës në det.

ii) Operacionet detare për kontrollin e legjislacionit për sigurinë hidrolundrimore.

iii) Me kërkesë të strukturave të Policisë së Shtetit dhe atyre doganore siguron mbështetje për misionet e zbatimit të ligjit.

iv) Kur për veprimet e ndërmarra sipas nënndarjes “ii” më sipër, kërkohen atributet e policisë gjyqësore, vetëm personeli i Rojës Bregdetare apo i Forcës Detare, i cili gëzon këto attribute dhe ka trajnimin e përshtatshëm, mund t’i kryejë këto veprime. Trajnimi i nevojshëm përcaktohet me urdhër të përbashkët të ministrive të përfshira dhe të Prokurorisë së Përgjithshme.

c) Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit:

i) Operacionet detare për kontrollin e legjislacionit për trafikun detar.

ii) Hetimin e incidenteve detare.

ç) Ministrisë së Financave:

i) Operacionet detare për kontrollin e legjislacionit fiskal dhe doganor.

d) Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave:

i) Operacionet detare për kontrollin e zbatimit të legjislacionit për peshkimin.

ii) Operacionet për parandalimin dhe mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja.

dh) Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve:

i) Operacionet në mbështetje të sporteve ujore dhe nënujore.

ii) Operacionet në mbështetje të turizmit detar dhe bregdetar.

3. Procedurat operationale standarde (POS) përfshijnë çështjet e mëposhtme, por pa u kufizuar në to:

a) Plani i trajnimit të personelit të QNOD-së;

b) Proceset e raportimit dhe të menaxhimit të informacionit dhe listat e kontrollit;

c) Detyrat, përgjegjësitë, masat për bashkërendimin e punës dhe procedurat e funksionimit si qendër kombëtare të shpëtimit detar;

ç) Proceset dhe mjetet për shkëmbimin e informacionit detar me institucionet shumëkombëshe dhe të huaja;

d) Proceset për garantimin e kontrollit civil të operationeve policore detare;

dh) Procedurat për drejtimin e mjeteve detare dhe sistemet e mbështetjes, që marrin pjesë në operationet detare;

e) Procedurat për përgatitjen e rekomandimeve për institucionet pjesëmarrëse, për trajnimin, shpërndarjen e burimeve dhe projektet e ardhshme të zhvillimit të kapaciteteve;

ë) Detyrat dhe përgjegjësitë e komandantëve në terren;

f) Detyrat dhe përgjegjësitë e oficerëve të shërbimit dhe personelit të shërbimit;

g) Detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorëve të institucioneve;

gj) Proceset për transferimin e autoritetit për incidentet e përmendura në kreun IV të këtij vendimi;

h) Proceset për bashkërendimin e komandimit e të kontrollit, të komunikimeve dhe çështjeve të menaxhimit të frekuencave;

i) Procedurat e posteve të punës.

V. Bashkërendimi, planifikimi dhe përgjegjësitë e institucioneve pjesëmarrëse

1. Institucionet e përfshira në QNOD bashkëveprojnë me njëra-tjetrën, për një kontribut maksimal në përmbushje të misionit të qendrës.

2. Koordinatorët e institucioneve marrin pjesë në planifikimin dhe vendimet, që kanë lidhje me institucionet, që përfaqësojnë, dhe bien dakord bashkërisht dhe garantojnë zbatimin e këtyre planeve.

3. Trajnimi i personelit dhe mbështetja me personel e mjeteve detare, të përfshira në operationet e kontrollit të hapësirës detare është përgjegjësi e institucionit, që i ka në pronësi këto mjete detare.

4. Sigurimi lundrimor për mjetet detare është përgjegjësi e institucioneve përkatëse.

5. QNOD-ja merr informacion nga sistemi i integruar i vëzhgimit të hapësirës detare, nga mjetet patrulluese në det, si dhe nga infrastruktura të tjera, në dispozicion të institucioneve, të përfshira në këtë qendër.

6. Institucionet pjesëmarrëse në QNOD bashkëveprojnë ngushtë për trajnimin dhe angazhimin, me qëllim që burimet të përdoren në mënyrë racionale dhe të rritet efektshmëria operationale detare.

7. Për çështjet, të cilat nuk rregullohen nga ky vendim, institucionet pjesëmarrëse mbështeten në marrëveshjet përkatëse, të nënshkruara në zbatim të nenit 10 të ligjit nr.8875, datë 4.4.2002 “Për Rojën Bregdetare Shqiptare”, të ndryshuar.

VI. Të fundit

1. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij

vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Mbrojtjes për bashkërendimin e procesit të hartimit të procedurave operacionale standarde brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.997, datë 13.5.2009

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.260, DATË 18.4.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR BOTIMIN, SHTYPJEN DHE SHPËRNDARJEN E TEKSTEVE
SHKOLLORE, TË SISTEMIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9, 56 e 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 6 të vendimit nr.260, datë 18.4.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 6/1, me këtë përmbajtje:

“6.1. Për nxënësit në arsimin 9-vjeçar, që vijnë nga familje ose shtresa sociale në nevojë dhe që përfitojnë ndihmë ekonomike, mbështetur në vendimin e organeve të pushtetit vendor për përfituesit e ndihmës ekonomike, çmimi i blerjes së teksteve për arsimin 9-vjeçar mbulohet, në formë kompensimi si “transfertë tek individit”, në masën 100 për qind të tij.”.

2. Efektet financiare për vitin 2009, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi buxhetor, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.998, datë 30.9.2009

PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSA E KONVIKTE, BURSAT E
SHTETIT DHE PAGESAT E NXËNËSVE DHE TË STUDENTËVE, NË INSTITUCIONET
ARSIMORE PUBLIKE, PËR VITIN SHKOLLOR 2009-2010

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, të nenit 29 të ligjit nr.8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formim profesional në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 57 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008, “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Nxënësit, që ndjekin studimet në institucionet arsimore publike, dhe studentët, që ndjekin një program studimi, të ciklit të parë, me kohë të plotë, në institucionet arsimore publike, mund të përfitojnë bursë dhe përfitime të tjera, të parashikuara në këtë vendim, nga buxheti vjetor, i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

2. Përfitojnë bursë, brenda kuotave dhe kriterëve të përcaktuara në këtë vendim:

2.1 Sipas kriterit ekonomik (nxënës/studentë)

a) Nxënësit/studentët, që vazhdojnë studimet larg vendbanimit të tyre, në largësinë mbi 5 km, dhe plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Nxënësit, që banojnë në fshat, pa shkollë 9-vjeçare, brenda rrezes prej 5 km, e që vendosen në konvikt publik.

c) Nxënësit/studentët, që kanë përfituar statusin e jetimit dhe që plotësojnë kriterin ekonomik.

ç) Nxënësit/studentët, të cilët kanë humbur kujdestarinë prindërore, me vendim gjykate, të formës së prerë, dhe që plotësojnë kriterin ekonomik.

d) Secili nga studentët bashkëshort, me fëmijë, që plotëson kriterin ekonomik e që vendoset në konvikt publik.

dh) Fëmija, nxënës apo student, që ka statusin e invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik, dhe që plotëson kriterin ekonomik.

2.2 Sipas rezultateve të arritura (nxënës/studentë)

a) Nxënësit e arsimit të mesëm profesional, që kanë mbaruar vitin shkollor pararendës, me të gjitha notat 10-ta.

b) Nxënësit, të cilët vazhdojnë studimet në shkollat profesionale, në degët bujqësore, veterinare, pyjore dhe ndërtim, në vitet e dyta e në vazhdim dhe që kanë mbaruar vitin akademik pararendës me notën mesatare mbi 8-të.

c) Studentët, që regjistrohen në vitin e parë të shkollës së lartë, e që kanë mbaruar shkollën e mesme me Medalje Ari.

ç) Studentët, që regjistrohen në vitin e parë të shkollës së lartë, e që janë shpallur nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës më të mirët e Maturës Shtetërore, sipas renditjes në listën e vlerësimit. Për vitin 2009, numri i tyre do të jetë 25 (njëzet e pesë) studentë. Kjo kategori studentësh përfiton bursë, kur studentët vazhdojnë studimet në institucionet e arsimit të lartë publik dhe vetëm për vitin shkollor 2009-2010.

d) Studentët, që kanë mbaruar vitin akademik, pararendës, me të gjitha notat 10-ta.

dh) Studentët, që vazhdojnë studimet në degët matematikë dhe fizikë, në vitet e dyta e lart dhe që e kanë përfunduar vitin akademik, pararendës, me notën mesatare mbi 8-të.

2.3. Jashtë kriterit ekonomik (nxënës/studentë)

a) Fëmija, nxënës apo student, i punonjësit të Policisë së Shtetit apo i Forcave të Armatosura, që kanë humbur jetën në krye e për shkak të detyrës. Në fillim të çdo viti akademik, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Mbrojtjes dërgojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës listën emërore të tyre.

b) Nxënësit, që vijnë nga zonat verilindore dhe juglindore të vendeve (Tropoja, Hasi, Puka, Kukësi, Dibra, Bulqiza, Mati, Mirdita, Malësia e Madhe, Librazhdi, Gramshi, Kolonja, Përmeti, Pogradeci, Skrapari, Tepelena dhe rrethi i Tiranës), të cilët regjistrohen dhe ndjekin studimet në vitin e parë shkollor, 2009-2010, në shkollat e mesme profesionale.

2.4 Sipas degëve parësore për zhvillimin e ekonomisë (nxënës)

Nxënësit, që regjistrohen e që ndjekin studimet në vitin e parë shkollor 2009-2010, në shkollat profesionale, në degët bujqësore, veterinare, pyjore dhe në ndërtim.

3. Nxënësit dhe studentët e të gjitha kategorive të mësipërme nuk përfitojnë bursë ose humbasin të drejtën e përfitimit të bursës, kur:

a) janë ndarë nga trangu familjar;

b) familjet e tyre ushtrojnë veprimtari private;

c) vazhdojnë studimet në një program të dytë studimi;

ç) shpallen mbetës dhe humbasin vitin shkollor, për arsye të rezultateve jokalue.ë.

4. Ministria e Arsimit dhe Shkencës harton planin e shpërndarjes së bursave, për drejtoritë arsimore rajonale (DAR) dhe zyrat arsimore (ZA), për vitet e para, sipas kuotave të miratuara (për nxënës/studentë).

DAR-ja/ ZA-ja, pas këshillimit me strukturat e pushtetit vendor, bëjnë planin e shpërndarjes së bursave në bashki dhe komuna, në përputhje me kërkesat e paraqitura, paraprakisht, prej tyre për kategoritë sipas pikës 2.1 të këtij vendimi.

5. Këshillat e bashkive dhe të komunave, në bazë të planit të përcaktuar për to nga DAR-ja/ ZA-ja, vendosin për dhënien e bursave, sipas kriterëve ekonomike, të përcaktuara në këtë vendim, duke u dhënë përparësi nxënësve/studentëve nga shtresat sociale në nevojë, për t'u trajtuar me bursë të plotë ose, në pamundësi, trajtimin me gjysmë burse.

5.1 Bashkitë dhe komunat, detyrimisht, u dërgojnë, në rrugë zyrtare, drejtorive arsimore rajonale apo zyrave arsimore përkatëse, vendimet për dhënien e bursave, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës.

5.2 Drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore duhet të dërgojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë, si dhe bashkive/komunave, që menaxhojnë konviktet, listën emërore të studentëve dhe të nxënësve bursistë, së bashku me vendimet origjinale të këshillave bashkiake dhe të komunave. Një kopje e kësaj liste dërgohet edhe në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

5.3 Plani i bursave për nxënësit, që regjistrohen dhe vazhdojnë studimet në vitin e parë shkollor 2009-2010, në shkollat profesionale, në degët bujqësore, veterinare, pyjore dhe ndërtim, jepen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës për bashkinë dhe komunën përkatëse, sipas vendndodhjes, territoriale dhe administrative, të konvikteve, ku janë vendosur nxënësit, sipas numrit të nxënësve të regjistruar në këto degë. Drejtoria arsimore rajonale dhe zyra arsimore, menjëherë, pas mbarimit të regjistrimit në këto degë, dërgon informacion në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, për numrin e nxënësve të regjistruar në këto degë.

6. Bursat e nxënësve, për vitet e dyta e lart, rishqyrtohen dhe miratohen, çdo vit, nga këshilli i bashkisë dhe komunës, sipas vendndodhjes, territoriale dhe administrative, të konvikteve, ku janë vendosur nxënësit konviktorë.

Nxënësit, që në vitin e parë kanë përfituar bursë, me vendim të këshillit të bashkisë apo komunës, ku kanë vendbanimin e përhershëm, e marrin këtë bursë deri në përfundim të viteve të shkollimit, nëse atyre nuk u ndryshojnë kriteret ekonomike dhe nuk rezultojnë mbetës.

7. Bursat e studentëve, për vitet e dyta e lart, rishqyrtohen dhe miratohen, çdo vit, nga institucionet e arsimit të lartë. Studentët e viteve të dyta e lart, që nuk kanë përfituar bursë dhe plotësojnë kriterin ekonomik, mund të përfitojnë bursë, brenda numrit të planit të bursave, të përcaktuar sipas këtij vendimi.

Numri i bursave për këtë kategori studentësh dhe për studentët, që përfitojnë bursë sipas pikës 2.2 të këtij vendimi, është deri në 150, në shkallë vendi, brenda numrit të përgjithshëm të bursave, të dhëna për vitin shkollor 2009-2010. Institucionet e arsimit të lartë paraqesin, në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, kërkesat për studentët, që përfitojnë bursë, sipas pikës 2.2 të këtij vendimi. Ministria e Arsimit dhe Shkencës harton planin e shpërndarjes, të cilin ia dërgon për ekzekutim institucioneve të arsimit të lartë.

Studentët, që, gjatë vitit të parë, kanë përfituar bursë me vendim të këshillit të bashkisë apo komunës, ku kanë vendbanimin e përhershëm, e marrin këtë bursë deri në përfundim të viteve të shkollimit, nëse atyre nuk u ndryshojnë kriteret ekonomike dhe nuk rezultojnë mbetës.

8. Nga plani i bursave, të miratuara për vitin shkollor 2009-2010, Bashkisë së Tiranës i jepen 10 (dhjetë) bursa për studentët, që vijnë nga familjet/shtresat sociale në nevojë, dhe për ato që janë invalidë, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, pavarësisht nga kriteri i studimit larg vendbanimit, ndërsa bashkive të tjera, të cilat në vendndodhjen e tyre territoriale kanë institucione të arsimit të lartë publik, u jepen deri në 5 (pesë) bursa për këtë kategori studentësh.

9. Nxënësit/studentët, që kanë përfituar statusin e jetimit, nxënësit e Institutit të fëmijëve, që nuk dëgjojnë dhe të Institutit të fëmijëve, që nuk shikojnë, përfitojnë falas veshmbathje, libra, fletore etj., sipas pasqyrës nr.6, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Kjo kategori nxënësish/studentësh përjashtohet nga detyrimet e tarifave të shërbimeve të ndryshme, që ofrojnë shkollat.

9.1 Nxënësve/studentëve, që kanë përfituar statusin e jetimit, u sigurohen falas, nga fondet e shkollave përkatëse, shërbimi shëndetësor, shërbimi dentar dhe medikamentet, pas paraqitjes së librezës dhe të kartës shëndetësore, si dhe të epikrizës, nga qendra spitalore e rrethit.

9.2 Nxënësit jetimë e përfitojnë bursën edhe gjatë pushimeve verore, si dhe vetëm një vit, kur humbasin vitin shkollor, për arsye të rezultateve jokalue.

9.3 Fëmijët dhe mësuesit e institucioneve të arsimit special, pa konvikt, trajtohen falas nga shteti, me një vakt ushqim (drekë), me vlerë deri në 150 (njëqind e pesëdhjetë) lekë në ditë.

10. Fondet buxhetore për mbulimin e shpenzimeve për bursat, si dhe numri i bursave për studentët administrohen nga institucionet e arsimit të lartë dhe u paguhen, çdo muaj, me kalim, në numrin e llogarisë bankare të çdo studenti.

10.1 Fondet buxhetore për mbulimin e shpenzimeve për bursat e nxënësve, si dhe numri i bursave për nxënësit administrohen nga bashkia/komuna, sipas vendndodhjes, territoriale dhe administrative, të konvikteve, ku janë vendosur nxënësit konviktorë. Nxënësit do t'i përfitojnë këto fonde vetëm me ushqim, në konvikt. Nxënësve, të cilët nuk janë vendosur/akomoduar në konvikt për mungesë kapacitetesh, u paguhet bursa çdo muaj nga bashkia/komuna, në llogarinë bankare të nxënësit përfitues.

11. Niveli i bursës për nxënësit dhe studentët jepet sipas pasqyrave nr.2 e nr.3, që i bashkëlidhen këtij vendimi, dhe kuota financiare ushqimore ditore jepet sipas pasqyrave nr.4 e nr.5, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

12. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për vitin e ri shkollor 2009-2010, të japë 1600 bursa për nxënësit dhe 1 600 bursa për studentët, për hyrjet e reja në vitin e parë në sistemin arsimor publik, për të gjitha kategoritë e parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi.

13. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin shkollor 2009-2010, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, për pjesën e vitit 2009, si dhe nga Buxheti i Shtetit, që do të miratohet për vitin 2010, për pjesën e vitit 2010.

14. Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave për vitet e para është data 15 dhjetor 2009, për të gjitha kategoritë e shkollave, ndërsa për vitet e dyta e lart, është data 15 nëntor 2009.

15. Vendimi nr.1211, datë 27.8.2008 i Këshillit të Ministrave "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, bursat e shtetit dhe pagesat e nxënësve dhe studentëve në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2008-2009", shfuqizohet.

16. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, DAR-të/ZA-të dhe institucionet e arsimit të lartë e njësitë e pushtetit vendor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PASQYRA NR.1

KUSHTET EKONOMIKE TË NXËNËSIT DHE TË STUDENTIT PËR DHËNIEN E BURSËS
(Viti mësimor 2008-2009)

Në lekë

Nr.	Përbërja familjare	Përfitojnë bursa	Përfitojnë gjysmëbursë	Me pagesë
	Për qytetin	Në të ardhura mujore lekë/frymë	Me të ardhura mujore lekë/frymë	Me të ardhura mujore lekë/frymë
1.	Për familjet me 2 persona	Deri 3200	3200-4600	Mbi 4600
2.	Për familjet me 3 persona	Deri 3100	3100-4500	Mbi 4500
3.	Për familjet me 4 persona	Deri 3000	3000-4400	Mbi 4400
4.	Për familjet me 5 persona	Deri 2900	2900-4300	Mbi 4300
5.	Për familjet me 6 persona	Deri 2800	2800-4200	Mbi 4200
6.	Për familjet me 7 persona	Deri 2700	2700-4100	Mbi 4100
7.	Për familjet me 8 persona	Deri 2600	2600-4000	Mbi 4000

Shënim. Nxënësit dhe studentët nga fshati përfitojnë bursë kur familja përfiton ndihmë ekonomike, në varësi të masës së kësaj ndihme, brenda planit të akorduar për secilën njësi të pushtetit vendor.

PASQYRA NR.2

NIVELI I BURSËS PËR NXËNËSIT (VITI MËSIMOR 2009-2010)

Në lekë

Nr.	Kategoritë e bursave sipas shkollave	Kuota e bursës			Financimi nga nxënësi	Financimi nga shteti
		Për kuotë ushqimi	Shpenzime vetjake	Totali i kuotës		
1	Shkollat 9-vjeçare dhe te mesme					
	a) Bursa	5,800	200	6,000	0	6,000
	b) Gjysmëbursa	5,800	200	6,000	3,000	3,000
	c) Me pagesë	5,800	200	6,000	6,000	0
2.	Shkolla e Mjeshtërisë Sportive dhe Arsimit Special					
	a) Bursa	6,300	200	6,500	0	6,500
	b) Gjysmëbursa	6,300	200	6,500	3,250	3,250
	c) Me pagesë	6,300	200	6,500	6,500	0
3.	Nxënësit jetimë	6,300	200	6,500	0	6,500

PASQYRA NR.3

NIVELI I BURSËS PËR STUDENTËT (VITI MËSIMOR 2009-2010)

Në lekë

Nr.	Kategoritë e bursave sipas shkollave	Kuotat e bursës			Financimi nga nxënësi	Financimi nga shteti
		Për kuotë ushqimi	Shpenzime vetjake	Totali i kuotës		
1.	Universitetet, Akademia e Arteve dhe shkollat e tjera të larta					
	a) Bursa	6500	2000	8500	0	8500
	b) Gjysmëbursa	6500	2000	8500	4250	4250
	c) Me pagesë	6500	2000	8500	8500	0
2.	Akademia e Edukimit Fizik dhe Sportiv					
	a) Bursa	7000	2000	9000	0	9000
	b) Gjysmëbursa	7000	2000	9000	4500	4500
	c) Me pagesë	7000	2000	9000	9000	0

PASQYRA NR.4

KUOTAT FINANCIARE SIPAS NORMAVE NË NATYRË PËR USHQIMIN E NXËNËSVE (VITI MËSIMOR 2008-2009)

Nr.	Emërtimi	Njësia matëse	Norma ditore	Vlera energjetike (në kcal)	Çmimi mesatar	Vlera ditore
1.	Bukë	gram	400	1117	80	32
2.	Makarona	“	30	107	50	1.5
3.	Oriz	“	30	109	80	2.4
4.	Sheqer	“	40	157	70	2.8
5.	Fasule	“	30	93	180	5.4
6.	Perime	“	130	27	84	10.9
7.	Fruta	“	100	42	950	9.5
8.	Vaj	“	30	270	220	6.6
9.	Gjalpë	“	20	152	500	10
10.	Mish	“	90	130	600	54
11.	Djathë	“	25	40	350	8.7
12.	Reçel	“	20	93	300	6
13.	Vezë	kokërr	1	42	12	12
14.	Qumësht	gram	200	98	40	8
15.	Patate	“	200	170	60	12
16.	Nënprodukt mishi	“	30	100	400	12
	Kuota ditore			2746		193.8

Shënim. Është e domosdoshme që nxënësi të marrë kuotë ditore në lekë dhe në kalori, ndërsa gramaturat dhe lloji i ushqimit mund të ndryshojnë sipas menuve të ndryshme, sipas çmimeve që ofrohen nga konkurrenca e prokurimeve dhe ndikimit të faktorëve të tjerë (Gramaturat e normës ditore në pasqyrë janë përdorur për efekt planifikimi.).

PASQYRA NR.5

KOTAT FINANCIARE SIPAS NORMAVE NË NATYRË PËR USHQIMIN E STUDENTËVE
(VITI MËSIMOR 2008-2009)

Nr.	Emërtimi	Njësia matëse	Norma ditore	Vlera energjetike (në kcal)	Çmimi mesatar	Vlera
1.	Bukë	gram	400	1117	80	32
2.	Makarona	“	30	107	50	1.5
3.	Oriz	“	40	145	80	3.2
4.	Sheqer	“	40	157	70	2.8
5.	Fasule	“	40	124	180	7.2
6.	Perime	“	130	27	84	10.9
7	Fruta	“	100	42	950	9.5
8.	Vaj	“	40	360	220	8.8
9.	Gjalp	“	20	152	500	10
10.	Mish	“	98	140	600	58.8
11.	Djath	“	42	66	350	14.7
12.	Reçel	“	44	190	300	13.2
13.	Patate	“	200	170	60	12
14.	Qumësht	“	200	98	40	8
15.	Vezë	Kokërr	1	42	12	12
16.	Nënprodukt mishi	Gram	30	100	400	12
	Kuota ditore			3037		216.6

PASQYRA NR.6

KUOTAT FINANCIARE TË VESHMBATHJES (VITI MËSIMOR 2008-2009)

Nr.	Emërtimi	Kuotat financiare në lekë veshmbathje për një vit kalendarik
1.	Për fëmijët e arsimit special	7000 (shtatë mijë) lekë
2.	Për jetimët	10000 (dhjetë mijë) lekë

VENDIM
Nr.999, datë 30.9.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË, “MASTER I NIVELIT TË PARË”, NË UNIVERSITETIN “ISMAIL QEMALI”, VLORË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pika 1.2.3, dhe 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, në Fakultetin e Ekonomisë dhe të Drejtësisë, të programeve të studimit të ciklit të dytë, “Master i nivelit të parë”, në:

a) “Sipërmarrje dhe turizëm”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë”, MNP, në sipërmarrje dhe turizëm;

b) “Administrim publik”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë”, MNP, në administrim publik.

2. Programi i studimeve të ciklit të dytë, “Master i nivelit të parë”, realizohet me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale është një vit.

3. Këto programe studimi të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, miratuar për universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1000, datë 30.9.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË, “MASTER I NIVELIT TË PARË”, NË UNIVERSITETIN “LUIGJ GURAKUQI”, SHKODËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pika 1.2.3, e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, të programit të studimit të ciklit të dytë, “Master i nivelit të parë”, në “Përkthim dhe interpretim në gjuhën gjermane”, në përfundim të të cilit lëshohet diploma “Master i nivelit të parë”, MNP, në përkthim dhe interpretim në gjuhën gjermane.

2. Programi i studimit të ciklit të dytë, “Master i nivelit të parë”, realizohet me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është një vit.

3. Ky program studimi ta fillojë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, miratuar për universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1001, datë 30.9.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË, “MASTER I NIVELIT TË PARË”, NË UNIVERSITETIN E TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pikat 1.2.3, e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin Histori-Filologji, të programeve të studimit të ciklit të dytë, “Master i nivelit të parë”, në:

a) “Redaktori”, në përfundim të të cilit lëshohet diploma “Master i nivelit të parë”, MNP, në redaktori;

b) “Gjeomorfologji”, në përfundim të të cilit lëshohet diploma “Master i nivelit të parë”, MNP, në gjeomorfologji;

c) “Arkivistikë”, në përfundim të të cilit lëshohet diploma “Master i nivelit të parë”, MNP, në arkivistikë;

2. Programet e studimeve të ciklit të dytë, “Master i nivelit të parë”, realizohen me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është një vit.

3. Këto programe studimi ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, miratuar për Universitetin e Tiranës.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1002, datë 30.9.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË, NË UNIVERSITETIN “ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pika 1.2.1, e 42, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, në Fakultetin e Ekonomisë, të programeve të studimit të ciklit të dytë, në:

a) “Menaxhim”, me profile:

i) Menaxhim biznesi, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë”, DND, në menaxhim, me profil menaxhim biznesi.

ii) Marketing, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë”, DND, në menaxhim, me profil marketing.

- b) "Politika dhe administrim", me profile:
- i) Administrim publik, në përfundim të të cilit lëshohet "Diplomë e nivelit të dytë", DND, në "Politika dhe administrim", me profil administrim publik.
 - ii) Administrim financiar, në përfundim të të cilit lëshohet "Diplomë e nivelit të dytë", DND, në "Politika dhe administrim", me profil administrim financiar.
- c) "Ekonomi-Biznes", me profile:
- i) Ekonomi biznesi, në përfundim të të cilit lëshohet "Diplomë e nivelit të dytë", DND, në "Ekonomi-Biznes", me profil ekonomi biznesi.
 - ii) Financë-Bankë, në përfundim të të cilit lëshohet "Diplomë e nivelit të dytë", DND, në "Ekonomi-Biznes", me profil financë-bankë.
2. Programet e studimit të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është dy vite.
3. Këto programe studimi ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.
4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009 miratuar për universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës.
5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1003, datë 30.9.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË, NË
UNIVERSITETIN "EQEREM ÇABEJ", GJIROKASTËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pika 1. 2.1, 29 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në universitetin "Eqerem Çabej", Gjirokastrë, në Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, në bashkëpunim me Universitetin e Maceratës, Itali, të programit të përbashkët të studimit të ciklit të dytë "Arkeologji dhe administrim i pasurive arkeologjike".
 2. Në përfundim të këtij programi studimi të ciklit të dytë lëshohet "Diplomë e nivelit të dytë", DND, e përbashkët, në "Arkeologji dhe administrim i pasurive arkeologjike".
 3. Ky program studimi i ciklit të dytë realizohet me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është dy vite.
 4. Programi i studimit "Arkeologji dhe administrim i pasurive arkeologjike" ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.
 5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për universitetin "Eqerem Çabej", Gjirokastrë.
 6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti "Eqerem Çabej", Gjirokastrë, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1004, datë 8.10.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË, “MASTER I NIVELIT TË DYTË”, NË GJUHËN SHQIPE, NË QENDRËN NDËRUNIVERSITARE TË STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6, pika 3, 26, pika 1.3.4, e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në Qendrën Ndëruniversitare të Studimeve Albanologjike, të programit të studimit, të ciklit të tretë, “Master i nivelit të dytë” (MND), në gjuhë shqipe.
 2. Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në gjuhë shqipe.
 3. Programi i studimit realizohet me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është 1 (një) vit.
 4. Ky program studimi ta fillojë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.
 5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, miratuar për Qendrën Ndëruniversitare të Studimeve Albanologjike.
 6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Qendra Ndëruniversitare e Studimeve Albanologjike për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1005, datë 8.10.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË TRETË “MASTER I NIVELIT TË DYTË”, NË FAKULTETIN E INXHINIERISË MEKANIKE TË UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pika 1.3.4, e 42, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, të Universitetit Politeknik të Tiranës, të programeve të studimeve të ciklit të tretë, “Master i nivelit të dytë”, si më poshtë vijon:
 - a) Në “Inxhinieri mekanike”, në profilet:
 - i) “Sistemet e prodhimit dhe proceset teknologjike”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), me profil “Sistemet e prodhimit dhe proceset teknologjike”.
 - ii) “Sistemet e energjisë dhe proceset termike”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), me profil “Sistemet e energjisë dhe proceset termike”.

iii) “Sistemet e transportit dhe menaxhimi i trafikut”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), me profil “Sistemet e transportit dhe menaxhimi i trafikut”.

b) Në “Materiale”, në profilet:

i) “Materiale metalike dhe alternative”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), me profil “Materiale metalike dhe alternative”.

ii) “Materiale tekstile”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), me profil “Materiale tekstile”.

2. Programet e studimeve “Master i nivelit të dytë” realizohen me jo më pak se 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është, të paktën, një vit.

3. Këto programe studimesh ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, miratuar për Universitetin Politeknik të Tiranës.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.1006, datë 8.10.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË TRETË, “MASTER I NIVELIT TË DYTË”, NË FAKULTETET E HISTORISË E FILOLOGJISË, TË GJUHËVE TË HUAJA DHE TË SHKENCAVE NATYRORE, TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pika 1.3.4, e 42, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e programeve të studimeve të ciklit të tretë, “Master i nivelit të dytë”, në Universitetin e Tiranës, në këto fakultete:

a) Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë:

i) Në “Histori”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në “Histori”.

ii) Në “Arkeologji”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në “Arkeologji”.

iii) Në “Trashëgimi kulturore”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në “Trashëgimi kulturore”.

iv) Në “Marrëdhënie ndërkombëtare”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në “Marrëdhënie ndërkombëtare”.

b) Fakulteti i Gjuhëve të Huaja:

i) Në “Shkenca gjuhësore”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në “Shkenca gjuhësore”.

ii) Në “Letërsi botërore”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në “Letërsi botërore”.

c) Fakulteti i Shkencave Natyrore:

i) Në “Matematikë teorike”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në “Matematikë teorike”.

ii) Në “Sisteme informatike të avancuara”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në “Sisteme informatike të avancuara”.

iii) Në “Fizikë”, në profilet:

- “Fizikë teorike llogaritëse”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), me profil “Fizikë teorike llogaritëse”.

- “Fizikë e aplikuar”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), me profil “Fizikë e aplikuar”.

- “Biofizikë”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), me profil “Biofizikë”.

iv) Në “Fizikë dhe kimi materialesh”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në “Fizikë dhe kimi materialesh”.

v) Në “Inxhinieri e proceseve kimike”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në “Inxhinieri e proceseve kimike”.

vi) Në “Teknologjitë dhe mikrobiologjitë e ushqimeve”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në “Teknologjitë dhe mikrobiologjitë e ushqimeve”.

vii) Në “Analiza kimike dhe instrumentale”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në “Analiza kimike dhe instrumentale”.

viii) Në “Biologji”, në profilet:

- Biologji shtazore”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), me profil “Biologji shtazore”.

- “Biologji bimore”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), me profil “Biologji bimore”.

- “Edukim biologjik”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), me profil “Edukim biologjik”.

ix) Në “Biologji eksperimentale”, në profilet:

- “Biologji qelizore”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), me profil “Biologji qelizore”.

- “Gjenetikë e popullatave”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), me profil “Gjenetikë e popullatave”.

- “Mikrobiologji”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), me profil “Mikrobiologji”.

2. Programet e studimeve të ciklit të tretë, “Master i nivelit të dytë”, realizohen me jo më pak se 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre, është, të paktën, një vit.

3. Këto programe studimi ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, miratuar për Universitetin e Tiranës.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1007, datë 8.10.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.863, DATË 29.7.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË SË SHKENCËS, TË TEKNOLOGJISË
DHE INOVACIONIT, 2009-2015”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 2 të vendimit nr.863, datë 29.7.2009 të Këshillit të Ministrave, emërtesa “Zëvendëskryeministri” zëvendësohet me “Ministri i Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1011, datë 14.10.2009

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT PHRD, NO.TF 093096, NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD), PËR PËRGATITJEN E
PROJEKTIT TË QEVERISJES, FINANCIVE DHE DHËNIES SË SHËRBIMEVE
BASHKIAKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit PHRD, NoTF 093096, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për përgatitjen e projektit të qeverisjes, financave dhe dhënies së shërbimeve bashkiake.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Banka Botërore

BANKE NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
SHOQATA NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM

1618 h Street N.W.
Washington D.C. 20433
U.S.A.

(202) 477-1234
Adresa: INTBAFRAD
Adresa: INDEVAS

26 gusht 2009

SHT Ridvan Bode
Ministër i Financave
Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë, Shqipëri

Re.: Shqipëri: Granti PHRD për përgatitjen e projektit të qeverisjes, financave dhe dhënies së shërbimeve për bashkitë
Nr.grantit TF093096

Shkëlqesi!

Në përgjigje të kërkesës për asistencë financiare të bërë në emër të Shqipërisë (Marrësi), jam i lumtur t'ju informoj që Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore), si administrator i fondeve të grantit të dhënë nga Japonia, propozon dhënien e një granti për Marrësin në një shumë që nuk kalon nëntëqind e tetëdhjetë mijë dollarë amerikanë (980,000 USD) (Granti) sipas termave dhe kushteve të parashikuara ose përmendura në këtë letërmarrëveshje (Marrëveshja), që përfshin aneksin e bashkëngjitur, për të asistuar në financimin e aktiviteteve të përshkruar në aneks (aktivitete).

Marrësi, nëpërmjet konfirmimit të pëlqimit të tij më poshtë, demonstroi që është i autorizuar ta lidhë këtë Marrëveshje dhe të kryejë aktivitetet në pajtim me termat dhe kushtet e parashikuara ose të referuara në këtë Marrëveshje. Dhënia e grantit nuk përbën apo nënkupton ndonjë detyrim nga ana e Bankës Botërore për të ndihmuar në financimin e ndonjë projekti që mund të rezultojë nga aktivitetet e financuara nga granti.

Jeni të lutur të konfirmoni pëlqimin e Marrësit për sa më sipër, duke caktuar një punonjës të autorizuar të Marrësit të nënshkruajë dhe vendosë datën në të dy kopjet e bashkëngjitura të kësaj Marrëveshjeje dhe duke kthyer njërin prej kopjeve të nënshkruara te Banka Botërore. Me marrjen nga Banka Botërore të kopjes së nënshkruar, kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit; me kusht që oferta e kësaj Marrëveshjeje konsiderohet e tërhequr nëse Banka Botërore nuk ka marrë një kopje të nënshkruar të kësaj Marrëveshjeje deri më 31 gusht 2009, përveç kur Banka Botërore cakton një datë të mëvonshme për këtë qëllim.

Sinqerisht i Juaji

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga: (firmë)
Jane Armitage
Drejtor vendi dhe koordinator rajonal
për Europën Juglindore,
Europën dhe rajonin e Azisë Qendrore

Rënë dakord:
Shqipëria

Nga: _____
Emri: _____
Titulli: _____
Datë: _____

Bashkëngjitur:

1. Kushte standarde për grantet e dhëna nga Banka Botërore, nga fonde të ndryshme, të datës 20 korrik 2006.

2. Letër disbursimi e datës 26 gusht 2009, së bashku me udhëzimet e disbursimit të Bankës Botërore për projektet, të datës 1 maj 2006

Granti PHRD, NR.TF 093096

Aneks

Neni 1

Kushtet standarde, përkufizime

1.01 Kushtet standarde

a) Kushtet standarde për grantet e dhëna nga Banka Botërore, nga fonde të ndryshme të datës 20 korrik 2006 (kushte standarde) përbëjnë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Përkufizime. Përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat me germa kapitale të përdorura në këtë Marrëveshje kanë kuptimet që u jepen atyre në kushtet standarde ose në këtë Marrëveshje; me kusht që për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje termi “Projekt”, sa herë që përdoret në kushtet standarde, do të thotë aktivitetet e përmendura në seksionin 2.01 të këtij aneksi.

Neni 2

Ekzekutimi i grantit

2.01 Objektivat dhe aktivitetet e grantit. Objektivi i grantit është përgatitja e projektit të qeverisjes, financave dhe dhënies së shërbimeve bashkiake (projekti), që ka si objektiva ngritjen e një kuadri për përfshirjen sistematike të sektorit bashkiak dhe mbështet reformat për të përmirësuar rezultatet e dhënies së shërbimeve nëpërmjet pjesëmarrjes së bashkive dhe ndërmarrjeve të tyre. Projekti është faza e parë e një programi afatgjatë për bashkitë në Shqipëri, që synon të arrijë dhënien e qëndrueshme të shërbimeve bashkiake nëpërmjet forcimit të financave dhe qeverisjes bashkiake dhe ndihmesën për Shqipërinë që të përmbushë kërkesat për aderimin në BE. Projekti synon të mbështesë shërbimet e ujërave, kanalizimeve, mbetjet inerte, rrugët lokale dhe shërbime të tjera që jepen nga bashkitë pjesëmarrëse. Aktivitetet (Aktivitetet) për të cilat jepet granti përbëhen nga ato aktivitete që mund të kërkojnë për përgatitjen e projektit dhe që janë aprovuar nga Banka Botërore herë pas here. Këto aktivitete mund të përfshijnë përgatitjen e studimeve të fisibilitetit, projekteve të hollësishme, vlerësimet ambientaliste, sociale, ekonomike dhe të tjera, zhvillimin e planeve për zbatimin e projektit, realizimin e konsultimeve me aktorët, trajnimin në vend, studime dhe seminare, sondazhe dhe dhënien e shërbimeve këshillimore teknike (duke përfshirë auditët) dhe mallrat që kërkojnë për realizimin e këtyre aktiviteteve.

2.02 Ekzekutimi i grantit në përgjithsi. Marrësi deklaron përkushtimin e tij për objektivat e projektit dhe grantit. Për këtë qëllim, Marrësi kryen aktivitetet në pajtim me dispozitat e nenit II të kushteve standarde dhe këtij neni II.

2.03 Menaxhimi financiar

a) Marrësi siguron që sistemi i menaxhimit financiar të mbahet në pajtim me dispozitat e seksionit 2.07 të kushteve standarde.

b) Marrësi, me kërkesë të Bankës Botërore, auditon pasqyrat financiare të aktiviteteve në pajtim me dispozitat e seksionit 2.07 b) të kushteve standarde. Secili auditim i tillë i pasqyrave financiare mbulon periudhën e treguar në kërkesën e Bankës Botërore. Pasqyrat financiare të audituara për secilën periudhë të tillë i jepen Bankës Botërore jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së kërkesës së Bankës Botërore.

2.04 Prokurimi

a) Të përgjithshme. Të gjitha mallrat dhe shërbimet e kërkuara për aktivitetet dhe që duhet të financohen nga shumat e grantit prokurohen në pajtim me kërkesat e parashikuara ose referuara në:

i) seksionin I (duke përjashtuar paragrafin 1.16 të “Udhëzimeve për prokurimin sipas huave IBRD dhe kreditë IDA” publikuar nga Banka Botërore në maj 2004 (udhëzimet e prokurimit), në rastin e mallrave; dhe

ii) seksionet I (duke përjashtuar paragrafin 1.24) dhe IV të “Udhëzimet: Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore”), të publikuar nga Banka Botërore (Udhëzimet për konsulentë) në rastin e shërbimeve të konsulentëve.

b) Përkufizime. Termat me germa kapitale të përdorura në paragrafët e mëposhtëm të këtij seksioni për të përshkruar metoda të caktuara prokurimi ose metodat e rishikimit nga Banka Botërore të kontratave të caktuara, i referohen metodës përkatëse të përshkruar në udhëzimet e prokurimit ose udhëzimet për konsulentët, sipas rastit.

c) Metoda të caktuara të prokurimit të mallrave

Përveç kur Banka Botërore bie dakord ndryshe, mallrat prokurohen sipas kontratave të dhëna mbi bazën e blerjes.

d) Metoda të caktuara të prokurimit të shërbimeve të konsulentëve

i) Përveç kur parashikohet ndryshe në pikën (ii) më poshtë, shërbimet e konsulentëve prokurohen sipas kontratave të dhëna mbi bazën e përzgjedhjes sipas cilësisë dhe koston.

ii) Metodatat e mëposhtme mund të përdoren për prokurimin e shërbimeve të konsulentëve për ato detyra që Banka Botërore bie dakord se përmbushin kërkesat e parashikuara në udhëzimet e konsulentëve për përdorimin e tyre: A) Përzgjedhje e bazuar në cilësi; B) Përzgjedhje e bazuar në një buxhet të caktuar; C) Përzgjedhje me koston më të ulët; D) Përzgjedhje e bazuar në kualifikimet e konsulentëve; E) Përzgjedhje me një burim; F) Përzgjedhje e konsulentëve individualë; dhe G) procedurat me burim të vetëm për përzgjedhjen e konsulentëve individualë.

e) Rishikimi nga Banka Botërore i vendimeve të prokurimit. Përveç kur Banka Botërore përcakton ndryshe nëpërmjet një njoftimi drejtuar Marrësit, kontrata e parë që duhet të jepet në bazë të çdo metode prokurimi i nënshtrohet rishikimit paraprak nga Banka Botërore. Të gjitha kontratat e tjera i nënshtrohen rishikimit pasues nga Banka Botërore.

Neni 3

Tërheqjet e shumave të grantit

3.01 Shpenzime të përshtatshme. Marrësi mund t'i tërheqë shumat e grantit në pajtim me dispozitat e: a) kushteve standarde, b) këtij seksioni; dhe c) çdo udhëzimi shtesë që Banka Botërore mund të përcaktojë duke njoftuar Marrësin (duke përfshirë udhëzimet e Bankës Botërore për disbursimin për projektet e muajit maj 2006, që rishikohet herë pas here nga Banka Botërore dhe që bëhet e zbatueshme në këtë Marrëveshje në pajtim me këto udhëzime), për të financuar shpenzimet e përshtatshme të përcaktuara në tabelën e mëposhtme. Tabela përcakton kategoritë e shpenzimeve të përshtatshme që mund të financohen nga shumat e grantit (kategori), alokimin e shumave të grantit për secilën kategori, dhe përqindjen e shpenzimeve që duhet të financohet për shpenzimet e përshtatshme në secilën kategori:

Kategoria	Shuma e grantit të alokuar (shprehur në USD)	Përqindja e shpenzimeve që duhet të financohet
1. Shërbime konsulentësh	900,000	100%
2. Kosto për mallra, trajnime dhe kosto operative	80,000	100%
Totali	980,000	

Për qëllimet e këtij seksioni: i) termi “trajnim” do të thotë trajnim i kryer në territorin e Marrësit, duke përfshirë blerjen dhe publikimin e materialeve, qiranë e ambienteve, tarifat e kursit dhe udhëtimin dhe qëndrimin e pjesëmarrësve; dhe ii) termi “kosto operative” janë kostot operative që kërkohen për aktivitetet duke përfshirë materialet e konsumit dhe furnizimet, komunikimet, shërbimet e medias dhe printimit, qiranë e automjeteve, operimin dhe mirëmbajtjen, tarifat për hapjen dhe operimin e llogarive bankare që kërkohen për aktivitetet dhe udhëtimin, fjetjen dhe dietat, por duke përjashtuar pagat e punonjësve të shërbimit civil të Marrësit.

3.02 Kushtet e tërheqjes. Pavarësisht nga dispozitat e seksionit 3.01 të kësaj Marrëveshjeje, asnjë tërheqje nuk bëhet për pagesat e bëra para datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje nga Marrësi.

3.03 Periudha e tërheqjes. Data e mbylljes, e përmendur në seksionin 3.06 (c) të kushteve standarde, është 31 mars 2011.

Neni 4

Përfaqësuesi i Marrësit; adresat

4.01 Përfaqësuesi i Marrësit. Përfaqësuesi i Marrësit i përmendur në seksionin 7.02 të kushteve standarde është:

4.02 Adresa e Marrësit. Adresa e Marrësit e përmendur në seksionin 7.01 të kushteve standarde është Ministri i Financave.

Ministria e Financave:
Buluverdi: "Dëshmorët e Kombit"
Nr.4, Tirana, Shqipëri
Faks. +355 42 28494

4.03 Adresa e Bankës Botërore. Adresa e Bankës Botërore, e përmendur në seksionin 7.01 të kushteve standarde, është:

International Development Association
1818 H Street N.W
Washington D.C. 20433
United States of America

Cable:
INDVAS
Washington D.C.

Teleks:
248423(MCI) ose
64145(MCI)

Faks.
1-202-477-6391

Banka Botërore

BANKE NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
SHOQATA NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM

1618 h Street N.W.
Washington D.C. 20433
U.S.A.

(202) 477-1234
Adresa: INTBAFRAD
Adresa: INDEVAS

26 gusht 2009

SHT Ridvan Bode
Ministër i Financave
Ministria e Financave
Bulevardi: "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë, Shqipëri

Shkëlqesi!

Re.: Nr i grantit PHRD TF093096-AL për përgatitjen e projektit të qeverisjes, financave dhe dhënies së shërbimeve bashkiake

Udhëzime shtesë: disbursime

I referohem letërmarrëveshjes (Marrëveshja) ndërmjet Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore) si administratore e fondeve të grantit, të dhëna nga Japonia dhe Shqipëria (Marrësi) për projektin e përmendur më sipër të datës 26 gusht 2009. Marrëveshja parashikon që Banka Botërore mund të nxjerrë udhëzime shtesë në lidhje me tërheqjen e shumave të grantit nr TF093096_AL (granti). Kjo letër (letër disbursimi), e rishikuar herë pas here, përbën udhëzime shtesë.

Udhëzimet e Bankës Botërore për disbursimet për projektet e datës 1 maj 2006, bashkëngjitur, (udhëzimet e disbursimit) (shtojca 1), janë një pjesë përbërëse e letrës së disbursimit. Mënyra në të cilën dispozitat e udhëzimeve të disbursimit zbatohen për grantin është e përcaktuar më poshtë. Seksionet dhe nënseksionet në parantezë më poshtë u referohen seksioneve dhe nënseksioneve përkatëse në udhëzimet e disbursimit dhe, përveç kur përcaktohet ndryshe në këtë letër, termat me germa kapitale të përdorura kanë kuptimet që u jepen atyre në udhëzimet e disbursimit.

I. Masat e disbursimit

i) Metodatat e disbursimit (seksioni 2). Metodatat e mëposhtme të disbursimit mund të përdoren për këtë grant:

- rimbursim,
- parapagim,
- pagesë e drejtpërdrejtë,
- detyrim i veçantë.

ii) Data e fundit e disbursimit (nëseksioni 3.7). Data e fundit e disbursimit është 4 muaj pas datës së mbylljes së përcaktuar në marrëveshjen e huasë. Çdo ndryshim deri në këtë datë njoftohet nga Banka Botërore.

II. Tërheqjet e shumave të grantit

i) Nënshkrimet e autorizuara (nëseksioni 3.1).

Një letër në formën e bashkëngjitur (shtojcë 2) duhet t'i jepet Bankës Botërore në adresën e treguar më poshtë duke dhënë emrin(at) dhe ekzemplarët e firmave të punonjësve të autorizuar për të nënshkruar kërkesat:

The World Bank
1818 H Street N.W
Washington D.C. 20433
United States of America

Në vëmendje të: Jane, Armitage, Drejtor vendi dhe koordinator rajonal për Europën Juglindore (Rajoni ECA).

ii) Kërkesat (Nëseksionet 3.2-3.3). Jeni të lutur të paraqisni të plotësuar dhe nënshkruar: a) kërkesat për tërheqje, së bashku me dokumentet shoqëruese; dhe b) kërkesat për kontribute të veçanta, së bashku me një kopje të letrës së kredisë së bankës tregtare, në adresën e treguar më poshtë:

The World Bank
Radnicka cesta 80, 9th floor
Zagreb, HR-10 000,
Croatia

Në vëmendje të: Grupi i menaxhimit të disbursimit

iii) Vlera minimale e kërkesave (nëseksioni 3.5). Vlera minimale e kërkesave për pagesë të drejtpërdrejtë dhe/ose lëshimin e kontributeve të veçanta është ekuivalenti i 19,600 USD.

iv) Parapagimet (seksionet 5 dhe 6).

- Tipi i llogarisë së caktuar (nëseksioni 5.3): e ndarë;
- Monedha e llogarisë së caktuar (nëseksioni 5.4): dollarë amerikanë (USD);
- Institucioni financiar ku llogaria e caktuar do të hapet (nëseksioni 5.5): në një bankë të Shqipërisë.

- Tavani (nëseksioni 6.1): 98,000 USD.

III. Raportimi mbi përdorimin e shumave të huasë

i) Dokumentacioni shoqërues (seksioni 4). Dokumentacioni shoqërues duhet të paraqitet me secilën kërkesë për tërheqje sipas parashikimit të mëposhtëm:

Për kërkesat për rimbursim:

- Lista e pagesave kundrejt kontratave që i nënshtrohen rishikimit paraprak të Bankës Botërore, në formën e bashkëngjitur (shtojca 4);

- Regjistrat që evidentojnë shpenzimet e përshtatshme (p.sh., kopje të faturave, fatura të furnitorëve/konsulentëve) për pagesat për shërbimet e konsulentëve kundrejt kontratave të vlerësuara me ekuivalentin e 100,000 USD ose më shumë për firma dhe me ekuivalentin e 50,000 USD për konsulentët individë;

- Pasqyrat e shpenzimeve në formën e bashkëngjitur (shtojca 3) për të gjitha shpenzimet/kontratat;

Për raportimin e shpenzimeve të përshtatshme të paguara nga llogaria e caktuar:

- Lista e pagesave kundrejt kontratave që i nënshtrohen rishikimit paraprak të Bankës Botërore, në formën e bashkëngjitur (shtojca 4);

- Regjistrat që evidentojnë shpenzimet e përshtatshme (p.sh., kopje të faturave, fatura të furnitorëve/konsulentëve) për pagesat për shërbimet e konsulentëve kundrejt kontratave të vlerësuara me ekuivalentin e 100,000 USD ose më shumë për firma dhe me ekuivalentin e 50,000 USD për konsulentët individë;

- Pasqyrat e shpenzimeve në formën e bashkëngjitur (shtojca 3) për të gjitha shpenzimet/kontratat;

Për kërkesat për pagesë të drejtpërdrejtë: regjistrat që evidentojnë shpenzime të përshtatshme p.sh. kopje për fatura, fatura të furnitorëve.

ii) Frekuenca e raportimit të shpenzimeve të përshtatshme të paguara nga llogaria e caktuar (nënseksioni 6.3). Kërkesat për plotësim duhet të paraqiten çdo muaj. Kërkesa për plotësim duhet të përfshijë pasqyrat e bashkërenduara të Bankës, si dhe dokumentet e tjera të përshtatshme shoqëruese.

IV. Informacion tjetër i rëndësishëm

Për informacion shtesë mbi masat e disbursimeve, jeni të lutur t'i referoheni manualit të disbursimit që ofrohet në faqen publike të Bankës Botërore te: <http://www.worldbank.org> dhe faqet e sigurta "Client Connection" te: <http://clientconnection.worldbank.org>. Kopje të printuara ofrohen me kërkesë.

Nëse nuk e keni bërë këtë, Banka Botërore rekomandon që ju të regjistroheni si përdorues i faqes client connection <http://clientconnection.worldbank.org>. Nga kjo faqe ju do të jeni në gjendje të shkarkoni kërkesat, të monitoroni statusin gati në kohë reale të grantit dhe të nxirrni informacionin përkatës politik, financiar dhe për prokurimin. Për më tepër informacion në lidhje me faqen e internetit dhe masat e regjistrimit, jeni të lutur të kontaktoni Bankën Botërore, me e-mail te clientconnection@worldbank.org.

Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me sa më sipër, jeni të lutur të kontaktoni z.Nicholay Chistyakov, financier i lartë te: loa-eca@worldbank.org duke përdorur referencën e mësipërme.

Sinqerisht i Juaji

IDA/IBRD

Nga: (firmë)

Jane Armitage

Drejtor vendi dhe koordinator rajonal

për Europën Juglindore,

Europën dhe rajonin e Azisë Qendrore

SHTOJCË

1. Udhëzimet e Bankës Botërore për disbursimet për projektet, datë 1 maj 2006
2. Formulari i firmave të autorizuara
3. Formulari i “Pasqyrës së shpenzimeve”
4. Formulari i pagesave kundrejt kontratave që i nënshtrohen rishikimit paraprak të Bankës Botërore

Përgatitur nga NEC

Për dijeni: Sherefedin Shehu, zëvendësministër
Ministria e Financave
Bulevardi: “Dëshmorët e Kombit”
Tirana, Shqipëri

Miratuar dhe për dijeni: J. Rieger, LEGEM
W. Zakout, ECSS6
J. Kamkëalala, ECSS6
Y. Zhang, ECSS6

SHTOJCË (2)

(Koka e letrës)
Ministria e Financave
Adresa e rrugës
Qyteti, vendi

(Datë)

The World Bank
1818 H Street N.W
Washington D.C. 20433
United States of America

Në vëmendje të: (drejtor vendi)

I nderuar (drejtor vendi)

Lënda:

I referohem Marrëveshjes së grantit (Marrëveshja) ndërmjet Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore) dhe Shqipërisë (Marrësi), datë _____, që parashikon grantin e mësipërm. Për qëllimet e seksionit 3.04(b) të kushteve standarde, sipas parashikimit në Marrëveshje, cilido¹ nga personat, ekzemplarët autentikë të firmave të të cilëve janë më poshtë, autorizohet në emër të Marrësit të nënshkruajë kërkesat për tërheqje (dhe kërkesat për një kontribut të veçantë) sipas këtij granti:

Emër, pozicioni, ekzemplari i firmës: _____
Emër, pozicioni, ekzemplari i firmës: _____
Emër, pozicioni, ekzemplari i firmës: _____

Sinqerisht i Juaji
(firmë)

pozicioni

¹ Udhëzimi për Marrësin për dërgimin e kësaj letrë te Banka Botërore: Përcakto nëse kërkesën duhet ta nënshkruajë më shumë se një person dhe sa ose cilat pozicione dhe nëse zbatohet ndonjë kufizim.

PAGESAT E BËRA GJATË PERIUDHËS SË RAPORTIMIT
KUNDREJT KONTRATAVE QË I NËNSHTROHEN RISHIKIMIT PARAPRAK TË SHOQATËS

VENDIM
Nr.1013, datë 14.10.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.399, DATË 22.4.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE PËRBËRJEN E
KOMISIONIT QENDROR TË REGJISTRIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.8669, datë 26.10.2000 “Për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë dhe banesave”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikat 1, 4 e 6 të vendimit nr.399, datë 22.4.2009 të Këshillit të Ministrave, emëtimi “...Zëvendëskryeministri...” zëvendësohet me “...Ministri i Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1015, datë 14.10.2009

PËR LEJIMIN E SHTYRJES SË AFATIT TË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT, ME
OBJEKT, PÛRKATËSISHT, “LICENCIMI I PLOTË I SISTEMIT TË THESARIT” DHE
“SHËRBIM KONSULENCE PËR SISTEMIN KOMPJUTERIK TË THESARIT”, NË
MINISTRINË E FINANCave

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 9 të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Financave, që, brenda datës 30.12.2009, të kryejë procedurat e prokurimit, me objekt:

a) “Licencimi i plotë i sistemit të Thesarit”;

b) “Konsulencë për sistemin kompjuterik të Thesarit, për transferimin e njohurive stafit funksional të Thesarit”.

Brenda këtij afati përfshihet edhe lidhja e kontratës përkatëse.

2. Fondi limit për kryerjen e procedurave të prokurimit me objekt:

- “Licencimi i plotë i sistemit të Thesarit” është në vlerën 20 220 000 (njëzet milionë e dyqind e njëzet mijë) lekë dhe përballohet nga buxheti i vitit 2009.

- “Konsulencë për sistemin kompjuterik të Thesarit për transferimin e njohurive stafit funksional të Thesarit” është në vlerën 19 000 000 (nëntëmbëdhjetë milionë) lekë dhe do të përballohen nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1016, datë 14.10.2009

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2009, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E ARSIMIT DHE SHKENCËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 12 të ligjit nr.10 025, datë 26.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, në buxhetin e miratuar për vitin 2009, në programin 09770 “Fonde për shkencën”, artikulli 230-231, t’i shtohet fondi prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare .

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori). Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 18.11.2009
Doli nga shtypi më 20.11.2009

Tirazhi: 3300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 32 lekë